

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

Programi Penal

Master



PUNIM DIPLOME

“Kompensimi i viktimave të krimit sipas legjislacionit kosovar dhe zbatimi në praktikë gjatë periudhës kohore 2017-2022”

Mentore:

Prof. Ass. Dr. Flutura Tahiraj

Kandidatja:

Qendresa Halili

Prishtinë

Shtator, 2024

ABSTRAKTI

Kompensimi i viktimave të krimit është e drejtë e viktimës përmes realizimit të së cilës viktimat përfiton dëmshpërblim financiar për dëmin e pësuar dhe fitimin e humbur. Kompensimin e viktimave parimisht duhet ta bëjë kryesi i veprës penale, por në rast të pamundësisë së kryesit për ta kompensuar viktimën, shteti ka detyrim ta kompensoj meqenëse ka dështuar ta mbrojë. Përmes kompensimit të viktimave të krimit nga shteti, viktimat përfitojnë ndihmë, mbështetje, rehabilitim dhe mjete financiare për humbjet të cilat i kanë pësuar. Programi i kompensimit të viktimave të krimit, karshi shumë shteteve të tjera dhe legjislacionit ndërkombëtar, bëhet pjesë e legjislacionit në Kosovë përmes Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të miratuar në vitin 2015.

Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit për herë të parë u implementua në vitin 2017, prandaj qëllimi i këtij hulumtimi është të analizoj rregullimin e kompensimit sipas legjislacionit kosovar dhe zbatimin e tij në praktikë gjatë periudhës kohore 2017-2022. Në këtë hulumtim është aplikuar metoda kualitative (deskriptive). Të dhënat janë mbledhur nga analizimi i legjislacionit për kompensimin e viktimave të krimit në Kosovë dhe nga Komisioni për kompensimin e viktimave të krimit. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se me miratimin e Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit u krijua një bazë ligjore solide që mundësoi realizimin e kompensimit për viktimat e krimit. Poashtu rezultatet tregojnë se përkundër zbatimit jo të mjaftueshëm të legjislacionit në praktikë, megjithatë vit pas viti shihet se ka pasur progres. Në këtë drejtim do të kontribuonte aplikimi i masave që ndihmojnë ngritjen e vetëdijës së viktimave për të realizuar të drejtën e tyre në kompensim, por edhe informimi i viktimave për këtë të drejtë nga profesionistët si mbrojtësit apo ndihmësit e viktimave.

Fjalët kyçe: viktimat e krimit, ligji për kompensimin, programi i kompensimi.